



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Divizioni për Monitorim

**Raport mbi monitorimin e uebfaqeve të institucioneve të
arsimit të lartë**

2025, Prishtinë



Hyrje

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), si institucion i pavarur përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, ka për mision mbrojtjen dhe avancimin e cilësisë akademike përmes standardeve të qarta dhe mekanizmave të monitorimit e vlerësimit. Në këtë kontekst, Divizioni për Monitorim luan një rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të akreditimit nga institucionet e arsimit të lartë (IAL), si dhe në identifikimin e sfidave dhe praktikave të mira që ndikojnë në cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), përmes Divizionit për Monitorim, gjatë muajit korrik 2025 ka realizuar procesin e monitorimit të uebfaqeve zyrtare të institucioneve të arsimit të lartë (IAL) në Republikën e Kosovës. Ky proces është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të garantuar respektimin e standardeve ligjore dhe të akreditimit nga ana e institucioneve në ofrimin dhe promovimin e programeve të tyre të studimit.

Procesi i monitorimit është zhvilluar në përputhje me kornizën ligjore dhe standardet e përcaktuara në Manualin për Metodologjinë e Monitorimit dhe Procedurat e pas Akreditimit, me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së konkurseve të shpallura të IAL-ve me vendimet për akreditim të miratuara nga KShC.

Qëllimi i monitorimit

Qëllimi kryesor i këtij monitorimi ka qenë të verifikohet nëse informacioni i publikuar në uebfaqet e IAL-ve, përkatësisht shpallja e konkurseve për pranimin e studentëve për vitin akademik 2025/2026, është në përputhje me vendimet e akreditimit të lëshuara nga AKA.

Objektivat specifike

Monitorimi është realizuar duke u bazuar në objektivat e mëposhtme:



- Verifikimi i përputhshmërisë së programeve të publikuara në konkurset e pranimi të studentëve për vitin akademik 2025/2026 me vendimet e akreditimit.
- Identifikimi i praktikave të gabuara si shpallja e programeve të paakredituara ose paraqitja e gabuar e specializimeve.
- Vlerësimi i qartësisë dhe saktësisë së informacionit të publikuar për studentët potencialë.
- Nxitja e transparencës dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës së komunikimit të IAL-ve me publikun.

Institucionet e monitoruara

Gjatë muajit Korrik 2025 janë monitoruar uebfaqet të gjithsej 22 institucione të arsimit të lartë:

- 9 institucione të arsimit të lartë publike
- 13 institucione të arsimit të lartë private

Tabela e IAL te monitoruara;

Nr.	Emri i institucionit	Publik/Privat
1	Universiteti Hasan Prishtina	Publik
2	Universiteti “Ukshin Hoti”	Publik
3	Universiteti “Kadri Zeka”	Publik
4	Universiteti “Isa Boletini”	Publik
5	Universiteti “Haxhi Zeka”	Publik
6	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj	Publik
7	Universiteti “Fehmi Agani” Gjakovë	Publik



8	IBCM	Publik
9	Fakulteti i Studimeve Islame	Publik
10	Kolegji AAB	Privat
11	Kolegji Heimerer	Privat
12	Kolegji Biznesi	Privat
13	Kolegji Rezonanca	Privat
14	Kolegji Pjeter Budi	Privat
15	Kolegji UBT	Privat
16	Kolegji Universum	Privat
17	Kolegji Fama	Privat
18	Akademia Evolucion	Privat
19	Kolegji Riinvest	Privat
20	Akademia Tempulli	Privat
21	Kolegji Dardania	Privat
22	Kolegji RIT Kosova (A.U.K)	Privat

Gjetjet gjatë procesit të monitorimit

Institucionet në përputhje të plotë me vendimet e akreditimit

Këto institucione kanë shpallur programe të studimit që janë në përputhje të plotë me vendimet e akreditimit të AKA-së:

- Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti Filozofik, Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Fakulteti i Arkitekturës, Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportit, Fakulteti i Edukimit dhe Fakulteti Juridik.



- Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren
- Universiteti “Fehmi Agani” – Gjakovë
- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- Universiteti “Isa Boletini” – Mitrovicë
- Kolegji IBCM
- Kolegji Rezonanca
- Kolegji RIT Kosova (A.U.K)
- Kolegji Biznesi
- Kolegji Tempulli
- Kolegji Dardania
- Akademia Evolution
- Kolegji Pjetër Budi

Institucionet të cilat kane shpallur konkurse në mospërputhje me vendimet e akreditimit

Këto institucione kanë shpallur programe të studimit në mospërputhje me vendimet e akreditimit të AKA-së:

Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Arteve

- Përdorimi i termit “profile” në vend të “specializim”.
- Prezantimi i termit ‘modul’ që nuk njihet nga AKA dhe nuk përfshihen në vendimet e akreditimit
- Mungesë konkursi për programin e akredituar “Bachelor i muzikës (në kompozim)”
- Shpërndarje jo e rregullt e kuotës së studentëve në mospërputhje me vendimet e akreditimit



Universiteti “Kadri Zeka” – Gjilan

- Të dhënat e programeve të shpallura në konkurs janë në përputhje me vendimet e AKA-së. Megjithatë në platformën e aplikimit online figurojnë programe të paakredituara si opsione zgjedhjeje.

Universiteti “Haxhi Zeka” – Pejë

- Fakulteti i Biznesit ka shpallur një specializim pa akreditim të emëruar si ‘Kontabilitet dhe Auditim’ në programin MSc Menaxhim Biznesi
- Disa programe kanë emërtime të pasakta.

Kolegji UBT

- Prezantim i shumë programeve pa akreditim, përfshirë Aktrim BA, Infermieri BSc, Shëndeti Publik MSc etj.
- Përdorim i emërtimeve jo konforme dhe mungesë specifikimi të nivelit të disa programeve.

Kolegji Riinvest

- Kolegji Riinvest nuk ka asnjë program të akredituar aktualisht megjithatë në uebfaqen e institucionit figurojnë programe që nuk janë të akredituara.
- Rekomandohet përditësimi i menjëhershëm i informacionit në uebfaqe.

Kolegji Universum

- Shpallje të programeve jo të akredituara në uebfaqe dhe rrjete sociale siq janë programet Bachelor Infermieri, Lojëra dhe Animacione, Fizioterapi, Intelgjencë Artificiale, Shkenca Politike dhe Gjuhë Angleze.



- Dega në Ferizaj ka të publikuar në rrjetin social 'Facebook' programin Shkenca Kompjuterike i cili nuk është i akredituar.

Kolegji Heimerer

- Specializimet në kuadër të programit BSc 'Shkencat Shëndetësore për profile Terapeutike' janë paraqitur si programe Bachelor (BSc Logopedi dhe BSc Ergoterapi)
- Emërtimi i programit BSc 'Shkencat Shëndetësore për profile Diagnostike – Teknik Laboratori' nuk përputhet me vendimin përkatës të validimit nga AKA.

Kolegji Fama

- Uebfaqja nuk ka qasje të plotë për të mundësuar një verifikim të detajuar.

Përfundim

Monitorimi i realizuar gjatë muajit Korrik 2025 tregon se:

- Shumica e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë janë në përputhje me vendimet e akreditimit të AKA-së, duke ofruar informacione të sakta, transparente dhe në përputhje me standardet ligjore dhe akademike.
- Një numër i institucioneve të arsimit të lartë kanë publikuar programe pa akreditim ose me gabime në emërtim dhe strukturë, çka përbën shkelje të kërkesave rregullative dhe mund të dezinformojë studentët potencialë.
- Përdorimi i terminologjisë jo të saktë (p.sh., profil/module në vend të specializim) dhe përfshirja e programeve të paakredituara paraqesin probleme serioze në aspektin e transparencës dhe respektimit të legjislacionit në fuqi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Pas dërgimit të raporteve të hartuara nga zyrtaret, të gjitha institucionet të cilat kanë pasur shkelje në uebfaqet e tyre, i kanë përmirësuar, gjë e cila është verifikuar nga zyrtaret.

Rekomandime

Për institucionet me parregullsi:

- Të përditësojnë uebfaqet duke u bazuar në vendimet e akreditimit të lëshuara nga AKA.
- Të largojnë menjëherë programet e paakredituara nga konkursat dhe kanalet e komunikimit publik.
- Të përdorin terminologjinë e saktë në emërtimet e programeve duke u bazuar në vendimet respektive të akreditimit.

Për institucionet në përputhje:

- Të vazhdojnë me qasje të transparencës dhe përditësimit të rregullt të uebfaqeve.